

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.1199/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm-Gjyqtari i vetëm gjykues Gëzim Ademi, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.J nga ..., ku edhe jeton ne rr. "...", për shkak te veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Mitrovice PP.nr.3095/2018 te datës 07.12.2018, ne mungese te prokurores Sahit Tmava, ne prezencën te te pandehurit Sh.J me datën 21.02.2019 ka shpallur publikisht, ndërsa me 27.02.2019 ka përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: Sh.J, nga i ati U., e ëma F., e vajzërisë I., i lindur me dt. ... ne ..., ku edhe jeton ne rr. "...", nr., me numër personal ..., i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me dt. 10.05.2017, rreth orës 15:00 në fshatin ..., komuna e ..., si pjesëmarrës ne trafik nuk u është përmbajtur rregullave te trafikut dhe me këtë ka rrezikuar trafikun publik, duke sjelle ne rrezik jetën dhe trupin e njerëzve, edhe pse ka qene i vetëdijshëm se mund te vije gjere te aksidenti ne trafik, por me lehtësi ka menduar se do te mund ta pengoj, ashtu qe ka drejtuar me automjetin motorik te udhëtareve te markës ‘Fiat Punto’, me targa ... duke qarkulluar ne rrugën magjistrale ...-..., ka humbur kontrollin ndaj automjetit dhe me pjesën e majte te përparme te automjetit te vet ka goditur ne pjesën e përparme anësore te anës se majte te automjetit “Golf2” me targa ... dhe me këtë ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 53 par.1 dhe nenit 65 par.1 te Ligjit për rregullat ne trafikun rrugor, me c ‘rast lëndime te lehta trupore ne forme te ndrydhjes te indeve te buta te krahut te dorës se majte ka pësuar e dëmtuara F.J.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par 1 të KPRK-ës.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,23,41,46,73, dhe 378 par 6 lidhur me par 1 te KPRK-se, dhe nenin 365, 450 dhe 463 te KPP-ës e:

G J Y K O N

DENIM MË GJOBË ne shume prej 300€ (treqind euro), te cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtu qe dënimin me gjobë do t’ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

OBLIGOHET i akuzuari qe t’i paguaj shpenzimet procedurale dhe atë, për ekspertizën mjeko-ligjor shumen prej 50€, për ekspertizën e komunikacionit shumen prej 35.77€ ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave te krimit, shumen prej 30 euro, dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumen prej 20 euro, të gjitha këto është i obliguar qe t’i paguaj ne afat

prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuze PP.nr.3095/2018 të datës 07.12.2018, kundër të pandehurit Sh.J, për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me 1 të KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.21.02.2019 ashtu që në këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: e pranoj fajësinë, me vjen keq për rastin që ka ndodhur, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris me vepra të tilla apo vepër tjetër penale, këtë e beje me vullnet dhe pa presionin e askujt.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet të provat materiale nga të cilat është ngritur aktakuza, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare e pa kurrfarë presioni nga ana e të njëjtit paraprakisht pas njoftimit nga ana e gjykatës me favoret dhe disfavoret e pranimit të fajësisë. Andaj nga kjo që u theksu i propozoj gjykatës që ta bëjë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit

II. Vlerësimi i pranimit të fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi që i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bënë në mënyrë vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje të qarte ligjore apo gabime faktike që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, të gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë në përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndes si: Raporti policor nr. ... i dt. 10.05.2017, Deklarata e të pandehurit e dt. 11.04.2017, Deklarata e të dëmtuarit J.T e dt.12.05.2017, Deklarata e të dëmtuarës F.J e dt. 11.05.2017, Deklarata e të dëmtuarit U.J të dt. 11.05.2017, Konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit F.T të dt. 23.11.2018, Konstatimi dhe mendimi i ekspertit të mjekësisë ligjore dr. V.H të dt. 09.10.2018 si dhe fotot e dokumentacionit që gjenden në shkresat e lëndes, nga të gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 8 lidhur me par 6 e 1 të KPRK-ës.

III. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me gjobë dhe burgim deri në 1 vit, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale, në rastin konkret i pandehuri kishte rrezikuar jetën e personit.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, i njëjti është mbajtës i familjes, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i tij me rastin e pranimit të fajësisë rezultojnë se ai edhe vet deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurit për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tij për veprën penale, si rrethane tjetër lehtësuese ka gjetur se në të dhënat e shkresave se lëndës nuk rezultojnë se ky i pandehur të jetë dënuar ndonjë herë për ndonjë veprë penale apo të jetë zhvilluar ndonjë procedurë penale, prandaj gjykata vlerëson se bazuar në këto rrethana ky i pandehur kishte rënë ndesh me ligjin vetëm me rastin konkret ku e ka pranuar fajësinë.

Nga të gjitha këto gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit pasi që për gjykatën në rrethana të tilla mjafton se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit do të ndalojë kryerësin që të mos kryej vepra penale në të ardhmen e që ky është edhe qëllimi i dënimit me kusht. Nga të gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson e edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit.

IV. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet procedurale dhe atë, për ekspertizën mjekoligjor shumen prej 50€, për ekspertizën e komunikacionit shumen prej 35.77€ ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, shumen prej 30 euro, dhe në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 euro, të gjitha këto është i obliguar që t'i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

V. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata të dëmtuarit i ka udhëzuar në konteste të rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në neni 248, 365, 450, e 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P. nr.1199/18 dt.27.02.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë në afat prej 15 ditëve në gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.